



Organizata për  
Demokraci, Antikorrupsion  
dhe Dinjitet, Çohu!



Pro Open

Koalicioni për Hajje të  
te Dhenave dhe Ulogarohënie  
në Prokurim Publik

# Tenderomania e (pa)ndëshkuar

Prokurimi në Retrospektivë  
Prokurimi dhe Prokuroritë



# **Tenderomania** **e (pa)ndëshkuar**

**Prokurimi në Retrospektivë**  
Prokurimi dhe Prokuroritë

Prill, 2018  
Prishtinë

Kjo analizë është mundësuar me mbështetje të  
Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur  
(KFOS)



**Deklaratë mohimi:**

Përmbajtja e kësaj analize është përgjegjësi e  
plotë e Organizatës Çohu!, dhe rrjedhimisht nuk  
reflekton qëndrimet e donatorëve të projektit.

**Autorë:**

Genc Nimoni, Arton Demhasaj

**Lekturoi:**

Besa Kalaja

**Layout & Design**

envinion

Origjinali është shkruar në shqip

**Publikuar nga:**

Organizata për Demokraci,  
Antkorrupsion dhe Dinjitet, Çohu!  
Rruga: UÇK 25-1 Rustem statovci Nr.17;  
Prishtinë, Kosova  
Tel / +381 (0)38 248 506  
[www.cohu.org](http://www.cohu.org)

---

# Përmbajtja

Lista e shkurtesave .....	4
<b>RETROSPEKTIVA E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË .....</b>	<b>7</b>
Përmbledhje ekzekutive.....	8
Metodologjia .....	9
Tenderomania - Perceptimet e një procesi teknik.....	10
a) Prokurimi publik si instrument i financimit të partive politike.....	11
b) Prokurimi publik si kulturë e pandëshkueshmërisë. ....	11
c) Prokurimi publik si bojkot ekonomik.....	11
Trashëgimia qytetare kundër korrupsionit në prokurimin publik-.....	12
<b>PROKURIMI DHE PROKURORITË.....</b>	<b>15</b>
Hyrje .....	16
Gjetjet.....	17
Numri i pamjaftueshëm me prokurorët.....	18
Profilizimi i prokurorëve dhe nevoja për avancimin profesional.....	20
Mungesa e ekspertëve .....	22
Mungesa e evidencave të plota si dhe kategorizimi i rasteve të prokurimit publik...	24
Kushtet e rënda të punës dhe mungesa e hapësirës – Prokuroria Themelore në Mitrovicë .....	26
Përfundime dhe rekomandime .....	28
Rekomandime .....	29



# Lista e shkurtesave

**DKR** Departamenti i Krimeve të Rënda

**DP** Departamenti i Përgjithshëm

**GDP** Bruto Produkti Vendor

**OShP** Organi Shqyrtues i Prokurimit

**GjTh** Gjykata Themelore

**KGjk** Këshilli Gjyqësor i Kosovës

**KPK** Këshilli Prokurorial i Kosovës

**KPRK** Kodi Penal i Republikës së Kosovës

**KPPRK** Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

**KEK** Korporata Energjetike e Kosovës

**KRPP** Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

**PSRK** Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

**PTh** Prokuroria Themelore

**QKUK** Qendra Klinike Universitare e Kosovës

**ShC** Shoqëria Civile

**ZKSh** Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

**ZKA** Zyra Kombëtare e Auditimit

**FOL** Lëvizja FOL

**KDI** Instituti Demokratik i Kosovës

**D+** Organizata Demokraci Plus

**Çohu!** Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, Çohu!

**RETROSPEKTIVA  
E PROKURIMIT  
PUBLIK NË KOSOVË**

---

# Përmbledhje ekzekutive

Në së paku 100 vitet e fundit, debati politik ka qenë i orientuar drejt konsolidimit të demokracisë dhe ekonomisë së lirë të tregut si dy shtylla komplementare që i përgjigjen më së miri shoqërisë bashkëkohore.

Natyrisht, fizionomia e demokracisë bashkëkohore nuk ka lindur aty për aty. Vendet që sot prijnë në zhvillimin shoqëror dhe demokratik, kanë kaluar epoka të rënda të përplasjeve si në rrafshin e brendshëm ashtu edhe në rrafshin e jashtëm para se të evoluojnë në formatin modern të shtetndërtimit.

Gjatë këtij evoluimi, demokracia në fazën e tranzicionit shpeshherë është shoqëruar me probleme që e kanë zbehur forcën e saj dhe besimin në të. Në mesin e shumë proceseve që kanë ndikuar në këtë drejtim, janë edhe sfidat në ndërtimin e institucioneve publike të përgjegjshme, transparente dhe logaridhënese.

Republika e Kosovës nga kjo perspektivë, ndan një fat të ngjashëm me demokracitë tranzitore. Përveç kontekstit historik dhe politik, periudha e dy dekadave të fundit u karakterizua edhe me sfida në konsolidimin e institucioneve publike të përgjegjshme dhe kredibile.

Ka shumë debate brenda dhe rreth sferës institucionale që rëndojnë mbi njëra-tjetrën por emëruesi i përbashkët i sfidave të shtetndërtimit institucional të Kosovës lidhet drejtpërdrejt me një dukuri: korrupsionin zyrtar.

Korrupsioni zyrtar ka qenë dhe vazhdon të jetë një dukuri për të cilën ekzistojnë perceptimet e fuqishme, dhe e cila po shkakton edhe sot e kësaj dite deficit në botëkuptimin e demokracisë sonë të re.

Korrupsioni zyrtar apo ai që ndodh në nivelin zyrtar dhe institucional, në mesin e shumë fytyrave të shpërfaqjes që ka, në Kosovë si edhe në vendet tjera në tranzicion lidhet pikësisht me keqpërdorimin e buxhetit publik të krijuar nga taksapaguesit.

Keqpërdorimi i buxhetit të taksapaguesve po ashtu ndodh në disa forma, kryefjala e të cilave lidhet me procesin e prokurimit publik.

Ky punim analitik ka për qëllim të hedhë dritë mbi retrospektivën e prokurimit publik dhe kontributit që ka dhënë shoqëria civile në Kosovë gjatë dekadës së fundit për t'i demaskuar shkeljet në këtë proces.

Analiza merret me trashëgiminë që shoqëria civile ka lënë në luftën kundër keqpërdorimit të parave të taksapaguesve dhe nuk synon të thellohet në detaje përshkruese të prokurimit si proces.

Pjesa substanciale e saj paraqet, përveç tjerash, edhe debatet që e kanë karakterizuar këtë agjendë si dhe rekomandime se në ç'drejtim duhet të orientohet puna e shoqërisë civile që prokurimi publik të jetë sa më transparent dhe i realizuar ekskluzivisht mbi bazën ligjore që e rregullon atë.



---

# Metodologjia

Hartimi i kësaj analize është bërë duke marrë për bazë hulumtimin e dokumenteve, raporteve vendore dhe ndërkombëtare që trajtojnë çështjen e prokurimit publik dhe problemeve që ndërlidhen me të, përgjatë dekadës së fundit në Kosovë si dhe intervista të drejtëpërdrejta me akterë të shoqërisë civile. Kriteret e konsultimit të raporteve të shoqërisë civile janë vendosur duke pasur për bazë tri kategori themelore:

- **Hulumtimin;**
- **Raportimin; dhe**
- **Monitorimin**

Fokusi është drejtuar në evidentimin e fushave prioritare të cilat janë trajtuar nga shoqëria civile, të gjeturat kryesore të raportimit të tyre dhe një përmbledhje të rekomandimeve të dala nga shoqëria civile për ngritjen e efektivitetit dhe të transparencës së këtij procesi.

Po ashtu, analiza është ndërtuar në atë mënyrë që të thellojë njohuritë rreth prokurimin publik, me theks të veçantë në ato instanca të cilat kanë mbetur pa u trajtuar nga organizatat e shoqërisë civile më herët, e që paraqesin fusha të rëndësishme në agjendën e përgjithshme të avancimit të debatit për forcimin e integritetit të prokurimit publik në Republikën e Kosovës.



---

# Tenderomania - Perceptimet e një procesit teknik

Prokurimi publik paraqet një proces tejet të rëndësishëm për shkak se ai përdoret nga qeveria për të blerë mallra dhe shërbime, vlerat e të cilave zakonisht përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të GDP-së. Rrjedhimisht, si proces që realizohet përmes përdorimit të parave të taksapaguesve, ky proces duhet të jetë transparent, efikas, konkurrues dhe në dobi të së mirës së përgjithshme.

Për shkak të natyrës kontraktuale të prokurimit publik me akterë ekonomikë nga sfera private, shpeshherë ky proces është parë si një vegël për keqpërdorimin e mjeteve publike, korrupsionit dhe ndikimit jo të barabartë ndërmjet akterëve ekonomikë dhe zbatuesve qeveritarë të prokurimit publik.

Si temë që lidhet me mundësinë e keqpërdorimit të mjeteve publike, duke përfshirë edhe faktin se ekziston një përshtypje e përgjithshme e pranisë së dukurisë së korrupsionit në institucionet publike të Republikës së Kosovës, kjo temë ka qenë në fokus të monitorimit, hulumtimit dhe raportimit nga ana e organizatave të shoqërisë civile për vite me radhë.

Prokurimi publik në mendësinë institucionale kudo, e po ashtu edhe në Kosovë, është një proces i rregulluar me ligj, siç janë të rregulluara me ligj edhe të gjitha veprimtaritë e institucioneve publike. Republika e Kosovës është krijuar mbi parimet e demokracisë dhe rendi i saj kushtetues parasheh sundimin e ligjit si parimin përcaktues mbi të cilin organizohen raportet si në rrafshin e institucioneve me qytetarët ashtu edhe në rrafshin e institucioneve ndërmjet tyre.

Por, ka diçka në këtë mes që prokurimin publik e vendos në parametra të tjerë. Ndonëse me ligj ai është veç një proces i definuar në mënyrë precize përmes të cilit organet publike shpenzojnë buxhetin e shtetit të mbledhur nga taksapaguesit, në rrafshin praktik ky proces paraqitet të jetë “vrirja e zezë” e sistemit ekonomik dhe institucional të Republikës së Kosovës.

Nga të gjitha sfidat me të cilat është ballafaquar shtetndërtimi i Kosovës, prokurimi publik gjendet në shkallën më të ulët të standardeve të besueshmërisë, për shkak se ai ka shërbyer për keqpërdorime enorme të buxhetit të taksapaguesve.

Ekziston një perceptim i skajshëm se çdo zyrtar prokurimi paraqet njësinë e parë të korrupsionit institucional dhe më gjerë. Ky perceptim, ndonëse i padefinuar, ka shumë gjasa të ketë bazë reale, dhe ka përcaktuar me vite të tëra edhe shkallën e përgjithshme të besimit të qytetarëve në institucionet publike.

Debatet kryesore që e kanë karakterizuar fushën e prokurimit publik nga të gjeturat tona që kanë pasur në fokus qasjen e shoqërisë civile në këtë drejtim, mund të përmbledhen në fushat në vijim:

## **A** Prokurimi publik si instrument i financimit të partive politike.

Partitë politike në Kosovë në kuadër të shtrirjes së veprimit të tyre në njërin anë, si dhe në mungesë të fondeve dhe burimeve financiare legjitime në anën tjetër, e kanë shfrytëzuar instrumentin e prokurimit publik, për të krijuar lidhje klienteliste me bizneset përmes formulës së dhënies së tenderëve publikë për t'i tatuar pastaj jashtligjshëm me shumata të konsiderueshme të parave të cilat këto biznese përfituese të tenderëve është dashur t'u kthejnë prapa partive politike në pushtet. Kjo lidhje klienteliste është hasur si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal dhe është vendosur si kod i sjelljes së zakonshme në ambientin e të bërit biznes.

## **B** Prokurimi publik si kulturë e pandëshkueshmërisë

Për vite të tëra, korporatat e mëdha, ndërmarrjet publike dhe shërbimet publike si KEK-u, Posta, QKUK-ja, ministrinë etj, kanë dëmtuar buxhetin e Kosovës me kontrata të pafavorshme ekonomike, duke zbatuar një prokurim i cili fare nuk korrespondonte me "publiken". Zyrtarët e prokurimit të këtyre ndërmarrjeve kanë vazhduar të ushtrojnë detyrën e tyre pa u ndëshkuar asnjëherë për veprimet antiligjore në proceset e prokurimit. Kjo ka ndikuar në "shpikjen" e kategorisë së zyrtarëve të prokurimit si persona me lidhje të fuqishme, puna e të cilëve nuk mund të adresohet në mënyrë ligjore. Ndonëse në dukje e sipër ka pasur iniciativa penale kundër kësaj pjese të institucioneve publike, ka fare pak raste kur zyrtarët e prokurimit kanë përfunduar me përgjegjësi penale për shkeljen e ligjit. Si rrjedhojë, shembulli i pasurimit të shpejtë që haset tek një pjesë e madhe e tyre kundrejt masave spontane institucionale për të luftuar korrupsionin, kanë ndikuar në krijimin e një klime të pandëshkueshmërisë ndaj shkelësve të ligjit. Kjo klimë, edhe sot e kësaj dite vazhdon të diskreditojë edhe atë pjesë të zyrtarëve të prokurimit të cilët përpiqen të ushtrojnë detyrën e tyre me përgjegjësi dhe mbi bazën ligjore.

## **C** Prokurimi publik si bojkot ekonomik.

Kur flasim për një situatë në të cilën partitë politike në pushtet kanë në dorë instrumentet e përdorimit të parasë publike, është shumë e arsyeshme të mendohet se kush ka predispozita më të mira për të qenë përfitues i tyre. Pasqyrime të kësaj natyre ka pasur edhe në Kosovë. Bizneset që kanë qenë të përfshira si mbështetëse të një partie të caktuar, kanë rënë viktimë e anashkalimit me rastin e ardhjes në pushtet të një partie tjetër. Akoma më keq ka qenë situata me ato biznese që fare s'i kanë takuar sferës së politikës. Bizneset e tilla kanë pasur gjasa minimale për të përfituar kontrata publike të çfarëdo vlere. Kështu, prokurimi publik në Kosovë, në vend se të jetë mundësi për bizneset për të qenë furnizues dhe kontraktues të mallrave dhe shërbimeve përmes një tenderimi transparent, ligjor dhe të barabartë, në masën më të madhe ka qenë ose monopol i një biznesi të caktuar ose bojkotim i çdo biznesi që s'ka pasur lidhje me politikën.

**PËR SHKAK TË NATYRËS KONTRAKTUALE TË PROKURIMIT PUBLIK ME AKTERË EKONOMIKË NGA SFERA PRIVATE, SHPESHHERË KY PROCES ËSHTË PARË SI NJË VEGËL PËR KEQPËRDORIMIN E MJETEVE PUBLIKE, KORRUPSIONIT DHE NDIKIMIT JO TË BARABARTË NDËRMJET AKTERËVE EKONOMIKË DHE ZBATUESVE QEVERITARË TË PROKURIMIT PUBLIK.**

# Trashëgimia qytetare kundër korrupsionit në prokurimin publik -

## Retrospektivë e veprimtarisë së shoqërisë civile

Përballë problemit të korrupsionit institucional, qytetaria kosovare e shprehur në forma të ndryshme e më së shumti përmes veprimtarisë së shoqërisë civile, për vite të tëra i ka dalë përballë fenomenit të korrupsionit dhe veçmas atij që lidhet me prokurimin publik. Puna që shoqëria civile ka bërë në këtë drejtim mund të përmbledhet brenda trajtimit që përcjell një pyetje themelore:

Kur është fjala për zbulimin e korrupsionit dhe shkeljeve që ndërlidhen me prokurimin publik, pothuajse të gjitha organizatat joqeveritare në Kosovë së paku një herë gjatë veprimtarisë së tyre disavjeçare, e kanë ngritur si shqetësim këtë problem. Megjithatë, në mesin e OJQ-ve që në mënyrë direkte kanë dhënë kontribut në këtë agjendë dhe që kanë specializuar në fushën e monitorimit të prokurimit publik mund të përmendet organizatat në vijim:

### **A** Levizja FOL

Ndonëse e themeluar në vitin 2008, respektivisht më vonë se disa prej organizatave të shoqërisë civile që tashmë po hyjnë në fundin e dekadës së dytë, Levizja FOL është njëra prej organizatave aktive me monitorimet dhe publikimet e raporteve dhe analizave që për fokus kryesor kanë prokurimin publik.<sup>1</sup> Kjo organizatë është marrë me monitorim të rasteve individuale që nga procesi i ftesës për shprehje interesi e deri në shpalljen e përfituesve duke nxitur kështu debate të mëdha për shkallën e performancës së tenderimit në nivel të ministrive të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

### **B** Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)

Është themeluar në vitin 2005 dhe në kuadër të programeve kundër korrupsionit, për një periudhë relativisht të gjatë është marrë edhe me çështjen e prokurimit publik, veçmas analizimin e funksionimit të mekanizmave parandalues, kontrollues dhe ligjzbatues të prokurimit publik në Republikën e Kosovës.

<sup>1</sup> <http://levizjafol.org/publikimet/>

## **(TENDEROMANIA) FLET PËR NATYRËN SE SI PERCEPTOHET PROKURIMI SI MJET KORRUPSIONI DHE PASURIMI TË PALIGJSHËM DHE ÇFARË KA NDIKUAR NË RRRITJEN E KËTIJ PERCEPTIMI NË KOSOVË.**

**KAPITULLI I PARË,** (Tenderomania) flet për natyrën se si perceptohet prokurimi si mjet korrupsioni dhe pasurimi të paligjshëm dhe çfarë ka ndikuar në rritjen e këtij perceptimi në Kosovë. Me theks të veçantë, kapitulli trajton këtë problem në një dimension që mund të përmblihet në një pyetje:

Si ka mundësi që një proces i cili do të duhej të ishte dhe është teknik për nga natyra (prokurimi si procedurë) të bëhet tema themelore e cila karakterizon natyrën e institucioneve të Kosovës nga niveli qendror në atë lokal dhe nga organet më të larta shtetërore e deri tek zyrat e njësive lokale?

Në këtë kapitull janë përfshirë edhe llojet më të shpeshta të keqpërdorimeve të prokurimit publik që dominojnë në debatin ekzistues në Kosovë.

Kapitulli i dytë (trashëgimia qytetare) përfshin një përmbledhje të shkurtë të punës dhe të veprimtarisë së qytetarisë në përgjithësi dhe me theks të veçantë të punës së organizatave të shoqërisë civile në përpjekjet e tyre për të luftuar, për të kundërshtuar dhe për t'i raportuar keqpërdorimet në prokurimin publik ndër vite.

Kjo retrospektivë përfshin diskutimin si për nivelin qendror ashtu edhe për atë lokal. Po ashtu, këtu adresohen disa prej fushave kryesore që janë identifikuar nga ana e shoqërisë civile dhe që kanë qenë në fokus të përpjekjeve ndër vite. Ky kapitull jep të dhëna edhe për rekomandimet e dala nga shoqëria civile ndër vite me qëllim të përmirësimit të nevojshëm të prokurimit publik në mënyrë që të evitohen keqpërdorimet e mundshme. Me theks të veçantë trajtohet mungesa e transparencës dhe e llogaridhënies.

Në këtë kapitull dhe në rekomandimet themelore, raporti shpërfaq edhe një herë në mënyrë të përgjithshme konceptet dhe nocionet që duhet të zënë vend dhe t'i prijnë debatit për prokurim publik transparent dhe llogaridhënës. Po ashtu, janë të përmbledhura rekomandimet rreth asaj se çfarë është thënë dhe çfarë duhet bërë tani e tuje, si dhe në ç'mënyrë mund të kontribuojnë si akterët institucionalë ashtu edhe ata të shoqërisë civile në mënyrë që t'i rikthehet kredibiliteti këtij procesi të rëndësishëm institucional.





# **PROKURIMI DHE PROKURORITË**

# Hyrje

Prokurimi publik vazhdon të mbetet një ndër komponentët e rëndësishëm në proceset publike të shpenzimit të parasë publike.

Procedurat tenderuese shpeshherë nuk kanë shkuar sipas dispozitave ligjore, me ç'rast mosrespektimi i procedurave ligjore dhe shkelja e ligjeve kishte rezultuar me keqpërdorimin e parasë publike nga institucionet dhe nga zyrtarë të shumtë.

Sistemi prokurorial ballafaqohet më një numër të konsiderueshëm të lëndëve në të cilat janë të përfshirë zyrtarë të shumtë publikë të cilët ngarkohen për veprat penale të natyrës korruptive, pikërisht për shkak të keqpërdorimeve të procedurave të ndryshme të prokurimit publik. Sipas të dhënave të Këshillit Prokurorial të Kosovës, vetëm gjatë vitit 2016, prokuroritë themelore dhe Prokuroria Speciale kanë qenë të ngarkuara me gjithsej 984 raste të natyrës së korrupsionit me 2,491 persona ku kanë qenë të përfshirë gjithashtu rastet e prokurimit publik. Në anën tjetër, gjykatat themelore të Kosovës, bazuar në të dhënat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjatë vitit 2016 janë ngarkuar me gjithsej 929 lëndë të natyrës së korrupsionit.

Edhe pse trajtimi i rasteve të korrupsionit (duke përfshirë rastet e prokurimit publik) po konsiderohet prioritet nga ana e prokurorive dhe gjykatave, një numër i konsiderueshëm i keqpërdorimeve në prokurimin publik mbetet i patrajtuar. Një përfundim i tillë mund të nxirret gjithashtu duke u bazuar në shkeljet e gjetura nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Bazuar në po këtë raport një numër i madh i shkeljeve të procedurave dhe, rrjedhimisht i keqpërdorimit të detyrës, rrjedh nga procedurat tenderuese gjatë procesit të prokurimit publik.

Mungesa e komunikimit dhe bashkëpunimit të mirëfilltë në mes të Zyrës së Auditorit në njërën anë dhe policisë dhe prokurorisë në anën tjetër, ka vështirësuar dhe ka pamundësuar trajtimin me efikasitet të rasteve të tilla të cilat lidhen me keqpërdorimet e procedurave të prokurimit publik. Vështirësisë dhe pamundësisë së trajtimit të rasteve të tilla i ka kontribuar edhe qasja pasive e prokurorisë dhe kërkesat e prokurorisë për të formalizuar bashkëpunimin me Zyrën e Auditorit për denoncimin e rasteve të tilla.

Duke u bazuar në dispozitat procedurale penale dhe ato kushtetuese, prokuroritë e Kosovës janë të obliguara që në rastet e cënimit të interesit publik dhe shkeljeve ligjore me rastin e publikimit të gjetjeve të auditimit, në të cilat ka dyshime për veprat penale, të ndërmarrin veprimet kushtetuese dhe ligjore për hetimin e keqpërdorimeve eventuale, pa konsideruar nevojën e pranimit të kërkesës dhe denoncimeve zyrtare të auditorit të përgjithshëm.

Bazuar në gjetjet e organizatës Çohu! një gjë e tillë pothuajse nuk kishte ndodhur, derisa kishte ardhur presioni publik ndaj organit të ndjekjes dhe vetë zyrës së auditorit për bashkëpunim dhe procedim të rasteve të tilla për të cilat dyshohet se ka elemente të veprës penale.



# Gjetjet

Gjatë muajit shtator, tetor dhe nëntor, Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu! ka filluar monitorimin e lëndëve të kësaj natyre si dhe procesin avokues dhe intervistues me kryeprokurorë të prokurorive themelore, asaj Speciale dhe me akterë të tjerë relevantë.

Bazuar në hulumtimin e organizatës Çohu! pas vizitave në prokurori dhe intervistave me kryeprokurorë në prokuroritë themelore, atë Speciale dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, janë identifikuar probleme të natyrave të ndryshme, duke filluar nga ato të thjeshta e teknike, deri te problemet të cilat edhe ndikojnë në mbarëvajtjen e proceseve.

Mungesa e numrit të prokurorëve të mjaftueshëm si dhe nevoja për prokurorë të profilizuar dhe profesionalë për lëndët e natyrës së prokurimit publik, janë gjetjet fillestare të organizatës Çohu! gjatë procesit monitorues dhe intervistues. Probleme të tjera të identifikuara janë gjithashtu mungesa e ekspertëve të prokurimit për nevojat e ekspertizave të prokurorisë në procesin hetues dhe argumentues për shkeljet e pretenduara si dhe evidencat jo të plota për disa prokurori për lëndët e prokurimit publik ndër vite.

Mungesa e bashkëpunimit në të kaluarën në mes të prokurorisë dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) si dhe mungesa e bashkëpunimit me Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), janë gjetjet e tjera të identifikuara gjatë trajtimit të kësaj teme.

Në anën tjetër, gjatë procesit monitorues dhe intervistues janë identifikuar edhe gjetje të veçanta për prokuroritë.

Derisa sfida kryesore e PSRK-së është mungesa e gatishmërisë së dëshmitarëve për të dëshmuar në proceset e tilla, PTh-ja në Mitrovicë është ballafaquar me kushtet e rënda të punës së prokurorëve si dhe mungesa e hapësirave të nevojshme për punë. Në

anën tjetër, në PTh-në në Prishtinë e cila edhe bart numrin më të madh të rasteve të korrupsionit, rrjedhimisht edhe të rasteve të prokurimit publik, vazhdon të ketë zvarritje të theksuara në trajtimin e rasteve të tilla, e që është edhe për shkak të pamundësisë së caktimit të ekspertëve të prokurimit.

Bazuar në monitorim dhe kryesisht intervistat me kryeprokurorë, Çohu! ka identifikuar gjetjet si në vijim:

- Numri i pamjaftueshëm i prokurorëve, në veçanti në Departamentin e Krimeve të Rënda;
- Mungesa e prokurorëve të profilizuar për rastet e prokurimit publik;
- Nevoja për ngritjen profesionale të prokurorëve, specializim në fushën e prokurimit publik;
- Mungesa e ekspertëve për angazhim në rastet e natyrës së prokurimit publik;
- Mungesa e evidencave të rasteve të prokurimit publik ndër vite;
- Mungesa e rasteve të kategorizuara të prokurimit publik;
- Bashkëpunimi i brishtë ndërinstitucional në fushën e prokurimit publik;
- Mosgatishmëria e dëshmitarëve për të dëshmuar në proceset të cilat kanë të bëjnë me prokurimin publik;
- Kushtet e rënda të punës dhe mungesa e hapësirës së mjaftueshme (PTh në Mitrovicë).

# Numri i pamjaftueshëm i prokurorëve

Duke u nisur nga të dhënat e KPK-së, sistemi prokurorial në Kosovë numëron gjithsej 164 prokurorë në të gjitha nivelet.

Në intervistat e zhvilluara me kryeprokurorë të prokurorive themelore, PSRK-ja dhe prokurorë në ZKSh, të intervistuarit kanë shfaqur brengën e tyre për numrin e vogël të prokurorëve në prokuroritë e tyre, në veçanti në Departamentin e Krimeve të Rënda pothuajse në të gjitha prokuroritë përkatëse.<sup>2</sup>

Sipas të dhënave të KPK-së, nga gjithsej 164 prokurorët e angazhuar në sistemin prokurorial, vetëm 43 prej tyre janë të angazhuar në Departamentin e Krimeve të Rënda.<sup>3</sup>

PTh-të në Mitrovicë, Gjakovë dhe Ferizaj janë prokuroritë me numrin më të vogël të prokurorëve në Departamentin e Krimeve të Rënda, përkundër mbulueshmërisë së madhe territoriale dhe numrit të madh të banorëve në ato komuna. Derisa PTh-ja në Mitrovicë ka 2 prokurorë dhe PTh-ja në Gjakovë ka 3 të tillë, PTh-ja në Ferizaj vazhdon të mbetet me vetëm një prokuror në Departamentin e Krimeve të Rënda.

Të tre kryeprokurorët për prokuroritë përkatëse në intervistat e tyre për Çohu! kanë deklaruar se ndër sfidat kryesore të tyre është edhe numri i pamjaftueshëm me

prokurorë, në veçanti ata të krimeve të rënda. Rritja e numrit të prokurorëve, që do të mjaftonte për trajtimin e rasteve në prokurori, do të mundësonte, sipas tyre, efikasitet më të shtuar të prokurorive në trajtimin e rasteve të ndryshme, rrjedhimisht edhe të rasteve të korrupsionit.<sup>4</sup>

PTh-ja në Prishtinë, përkundër numrit më të theksuar të prokurorëve në DKR dhe në të gjitha departamentet, vazhdon të ketë prokurorë të pamjaftueshëm nëse marrim parasysh numrin e madh të lëndëve. Me 18 prokurorë në DKR dhe gjithsej 54 prokurorë, sipas kategorizimit PTh-ja në Prishtinë do të duhej të numëronte mbi 70 prokurorë.<sup>5</sup>

Ndryshe nga kryeprokurorët e PTh-së në Gjakovë dhe Ferizaj të cilët nuk deklarohen për arsyet e mungesave të tilla, kryeprokurori i PTh-së në Mitrovicë problemin me mungesën e numrit të mjaftueshëm të prokurorëve dhe zvarritjen e emërimeve e arsyeton me faktin e kriterit për prokurorë nga minoriteti, kriter ky i vendosur edhe në Marrëveshjen e Brukselit.<sup>6</sup>

Sipas të dhënave të KPK-së, sistemi prokurorial i Kosovës sipas nevojave dhe kategorizimit të numrit të prokurorëve, lejon gjithsej 201 prokurorë. Sipas përfaqësuesve të Këshillit Prokurorial, aktualisht në proces rekrutimi janë 18 prokurorë të ri derisa 14 pozita të tjera janë të rezervuara për prokurorë

2 Valon Jupa – Menaxher i Zyrës për Mbrojtje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial në NJSHPP Këshilli Prokurorial i Kosovës, 12 tetor 2017.

3 Ibid.

4 Intervista me shkrim me kryeprokurorin e PTh-së në Mitrovicë, z. Shyqri Sylja, 26 shtator 2017; intervistat me kryeprokurorët e PTh-së në Gjakovë, z. Ali Selimaj, 27 shtator 2017, Gjakovë dhe, kryeprokurorin e PTh-së në Ferizaj, z. Shukri Jashari, intervistuar me 12 shtator 2017 në Ferizaj.

5 Shënim: "Në Prishtinë gjithsej kemi 53 prokurorë me kryeprokurorin, derisa do të duhej të kishte mbi 70 prokurorë, për të siguruar mbulim dhe efikasitet në punë. Kemi kërkuar disa herë që të kemi prokurorë të ri dhe staf mbështetës, mirëpo ende jemi me 53 prokurorë". Intervistë me prokurorin Kujtim Munishi, shef i DKR-së dhe Njësitit për Luftimin e Korrupsionit, Krimeve Ekonomike, Sekuesttrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme në PTh-së në Prishtinë, intervistuar më 10 nëntor 2017, Prishtinë.

6 Intervista me shkrim me kryeprokurorin e PTh-së në Mitrovicë, z. Shyqri Sylja, 26 shtator 2017; intervistat me kryeprokurorët e PTh-së në Gjakovë, z. Ali Selimaj, 27 shtator 2017, Gjakovë dhe, kryeprokurorin e PTh-së në Ferizaj, z. Shukri Jashari, intervistuar me 12 shtator 2017 në Ferizaj.



	ZKPSH	PSRK	Apel	Prishtinë	Prizren	Pejë	Gjilan	Mitrovicë	Gjakovë	Ferizaj	Totali
Kryeprokurorë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
DKR			3	18	5	5	6	2	3	1	43
Dep. Mitur				5	2	1	2	1	1	1	13
DP			2	30	11	6	8	8	7	9	81
Prokurorë	5	12									17
<b>Totali</b>	<b>6</b>	<b>13</b>	<b>6</b>	<b>54</b>	<b>19</b>	<b>13</b>	<b>17</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>164</b>

nga radhët e minoriteteve, bazuar në Marrëveshjen e Brukselit.<sup>7</sup>

Në tryezën e diskutimit për gjetjet në prokurori lidhur me efikasitetin e prokurorive me rastet e prokurimit

publik, përfaqësues nga Këshilli Prokurorial i Kosovës janë deklaruar se janë në fazë rekrutimi edhe për dy kontingjente të prokurorëve dhe pritet kompletimi i numrit të pozitave të parapara për prokurorë, i cili është 201.<sup>8</sup>

7 Shënim: Marrëveshja për Drejtësinë është nënshkruar ndërmjet palës kosovare dhe asaj serbe në Bruksel, në shkurt të vitit 2015, e cila ende nuk ka filuar të zbatohet.

8 Tryeze diskutimi me përfaqësues të institucioneve relevante dhe shoqëria civile si: Këshilli Prokurorial i Kosovës, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokuroria Speciale e Kosovës dhe prokuroritë themelore, Akademia e Drejtësisë, Agjencia Kundër Korrupsionit, Zyra Kombëtare e Auditimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Demokraci Plus (D+) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), mbajtur me 19 dhjetor në Prishtinë.



# Profilizimi i prokurorëve dhe nevoja për avancimin profesional

eptrat penale të natyrës së prokurimit publik, hyjnë gjithashtu në kuadër të veprave penale nga kapitulli i Korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare. Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në strategjitë e tyre për efikasitet në rastet e korrupsionit, kishin hartuar gjithashtu plane të veprimit me ç'rast edhe kishin bërë ndarjen e prokurorëve dhe gjykatësve të cilët do të trajtonin vetëm rastet e korrupsionit.<sup>9</sup>

Ndër sfidat dhe problemet e veçanta në secilën prokurori përveç numrit të vogël me prokurorë, është edhe mungesa e profilizimit të prokurorëve për rastet e prokurimit publik si dhe nevoja për ngritje të kapaciteteve profesionale të prokurorëve për natyrën e tillë të veprave.<sup>10</sup>

Pothuajse të gjitha prokuroritë themelore dhe PSRK-ja kanë potencuar si sfidë problemin e mungesave profesionale dhe nevojën për ngritje të kapaciteteve profesionale. PTH-ja në Prishtinë, PTH-ja në Prizren, PTH-ja në Gjakovë dhe PTH-ja në Ferizaj sipas kryeprokurorëve të tyre kanë nevojë për specializim dhe ngritje profesionale për lëndët e natyrës së

prokurimit publik,<sup>11</sup> derisa për të njëjtin shqetësim janë deklaruar edhe kryeprokurorët e PTH-së në Pejë, PTH-së Gjilan dhe PSRK-së.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në muajin dhjetor të vitit 2015 kishte nxjerrë vendim me anë të të cilit kishte themeluar Njësitin për Luftimin e Korrupsionit, Krimeve Ekonomike, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme në Departamentin e Krimeve të Rënda dhe atë të përgjithshëm në PTH në Prishtinë, i cili ishte funksionalizuar në muajin shkurt të vitit 2016.<sup>12</sup>

Edhe pse nuk kishte prokurorë të profilizuar për rastet e prokurimit, 10 prokurorët e angazhuar në kuadër të njësitit trajtojnë gjithashtu rastet e prokurimit, i cili ekziston vetëm në PTH në Prishtinë.

Ani pse vërehen shifra të procedimit më efikas në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit në PTH në Prishtinë, prapë mbetet shqetësuese mungesa e profilizimit të prokurorëve dhe mungesa e rezultateve për rastet e prokurimit publik.<sup>13</sup>

9 Shënim: Fillimisht më 1 nëntor 2013, KPK-ja kishte hartuar Planin e Veprimit për Britjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit, në përputhje me të cilin edhe kishte nxjerrë vendim për caktimin e Koordinatorës Nacionale për rastet e tilla - [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1363.2013-Vendim-Laura\\_Pula\\_emerohet\\_Kordinatore\\_nacionale\\_.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.1363.2013-Vendim-Laura_Pula_emerohet_Kordinatore_nacionale_.pdf), Planit Strategjik 2016 – 2018 - <http://kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dhe%20Raporte/Plani%20i%20Implementimit/Plani%20Strategjik%202016-2018.pdf>.

Plani i Veprimit për Zgjidhjen e Lëndëve të Korrupsionit, i miratuar në dhjetor 2015 nga GjKJ-ja në Prishtinë, i miratuar nga KPK me 1 nëntor 2013 në Prishtinë.

10 Shënim: Në intervistën e realizuar me z. Besim Kelmendi, prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, si sfida kryesore të Sistemit Prokurorial në trajtimin e rasteve në fushën e prokurimit publik, janë mungesat profesionale të prokurorëve të cilat vinë për shkak të mungesës së trajnimeve të mjaftueshme për të gjithë prokurorët në fushën e prokurimit publik, si dhe mungesa e ekspertëve që do të punonin në sistemin prokurorial, nëntor 2017, Prishtinë.

11 Shënim: Kujtim Munishi, shef i DKR-së dhe Njësitit për Luftimin e Korrupsionit, Krimeve Ekonomike, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme në PTH në Prishtinë deklaroi se prokurorëve në PTH në Prishtinë u nevojiten trajnimet profesionale, të specializuara në lëminë e korrupsionit dhe prokurimit publik, i intervistuar me 10 nëntor 2017, Prishtinë.

12 Vendimi numër 397/2015 i datës 29 dhjetor 2015 i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

13 Shënim: Kujtim Munishi, shef i DKR-së dhe Njësitit për Luftimin e Korrupsionit, Krimeve Ekonomike, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme në PTH në Prishtinë deklaroi se Njësitit nuk është i profilizuar në veçanti për rastet e prokurimit, intervistuar me 10 nëntor 2017, Prishtinë.

## ÇOHU! U REKOMANDON PROKURORIVE THEMELORE, PSRK-SË DHE KËSHILLIT PROKURORIAL QË TË FILLONË SPECIALIZIMET E PROKURORËVE PËR NGRITJEN E TYRE PROFESIONALE DHE GJITHASHTU TË BËJNË KATEGORIZIMIN APO PROFILIZIMIN E PROKURORËVE TË VEÇANTË PËR RASTET E PROKURIMIT PUBLIK

Në tryezën e diskutimit me përfaqësues të institucioneve relevante dhe shoqërisë civile si: Këshilli Prokurorial i Kosovës, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokuroria Speciale e Kosovës dhe prokuroritë themelore, Akademia e Drejtësisë, Agjencia Kundër Korrupsionit, Zyra Kombëtare e Auditimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Demokraci Plus (D+) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), përfaqësues të Akademisë së Drejtësisë kanë potencuar trajnimet për prokurimin publik për prokurorë dhe gjykatës të cilat organizohen në dy sesione në vit.<sup>14</sup>

Madje, përfaqësues të KPK-së kanë konsideruar se profilizimi i prokurorëve dhe nevoja për ngritjen profesionale të tyre vazhdon të jetë sfidë e vazhdueshme e tërë sistemit prokurorial.<sup>15</sup>

Trajnimet e tilla për prokurim publik në kuadër të Akademisë së Drejtësisë, nuk janë të obligueshme dhe Çohu! konsideron se kjo është e metë tjetër e bashkëpunimit në mes të Akademisë së Drejtësisë dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Profilizimi i prokurorëve për rastet e prokurimit publik dhe obligueshmëria për avancimin profesional përmes vijimit të trajnimeve në Akademinë e Drejtësisë do të duhej të ishte hapi i parë dhe i domosdoshëm i bashkëpunimit të Këshillit Prokurorial dhe Akademisë së Drejtësisë.

Çohu! konsideron se mungesat profesionale janë defekte që vazhdojnë ta shoqërojnë tërë sistemin prokurorial. Mungesat e tilla profesionale vazhdojnë të pasqyrohen fillimisht në mungesën e efikasitetit të prokurorive dhe gjithashtu në pamundësinë e hetimit dhe të zbulimit të rasteve në të cilat ka dyshime për keqpërdorime eventuale në fushën e prokurimit publik.

Rritja e numrit të prokurorëve në proporcion me numrin e lëndëve dhe nevojat dhe profilizimi i tyre dhe avancimi profesional do të duhej të konsiderohen si çështje me prioritet për tërë sistemin prokurorial.

Andaj Çohu! u rekomandon fuqishëm prokurorive themelore, PSRK-së dhe Këshillit Prokurorial që të fillojnë specializimet të prokurorëve për ngritjen e tyre profesionale dhe gjithashtu të bëjnë kategorizimin apo profilizimin e prokurorëve të veçantë për rastet e prokurimit publik.

E gjithë kjo do të shpiente në trajtim më efikas të rasteve të prokurimit publik si dhe trajtim profesional të rasteve të tilla që do të rezultonte me të arriturat konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

14 Besim Morina – Koordinator i Programit në Akademinë e Drejtësisë, Tryeze diskutimi me përfaqësues të të institucioneve relevante dhe shoqëria civile si: Këshilli Prokurorial i Kosovës, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokuroria Speciale e Kosovës dhe prokuroritë themelore, Akademia e Drejtësisë, Agjencia Kundër Korrupsionit, Zyra Kombëtare e Auditimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Demokraci Plus (D+) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), mbajtur me 19 dhjetor në Prishtinë.

15 Lavdim Krasniqi – Drejtor i Sekretariatit të KPK-së; Tryeza e diskutimit me përfaqësues të të institucioneve relevante dhe shoqëria civile si: Këshilli Prokurorial i Kosovës, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokuroria Speciale e Kosovës dhe prokuroritë themelore, Akademia e Drejtësisë, Agjencia Kundër Korrupsionit, Zyra Kombëtare e Auditimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Demokraci Plus (D+) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), mbajtur me 19 dhjetor në Prishtinë.



# Mungesa e Ekspertëve

Për shkak të natyrës më komplekse të lëndëve të prokurimit publik, hetimi dhe zbardhja e rasteve vazhdon të hasë në vështirësi praktike gjatë trajtimit të tyre në prokurori.

Monitorimi i organizatës Çohu! dhe intervistat me kryeprokurorët kanë identifikuar vështirësi ë në zbardhjen e dyshimeve për keqpërdorimet eventuale në rastet e përfshira të kësaj natyre.

Vështirësia në hetim dhe argumentim të pretendimeve të prokurorisë vjen kryesisht për shkak të mungesave profesionale të prokurorisë dhe mungesës së ekspertëve të jashtëm në fushën e prokurimit publik. Kjo për shkak të natyrës komplekse të lëndëve të tilla, e cila ishte potencuar edhe nga kryeprokurorët e prokurorive përkatëse.

Në veçanti, mungesën e ekspertëve të cilët edhe do të ofronin ekspertizën e tyre të nevojshme për zbardhjen e rasteve, e kishte potencuar PTH-ja në Prishtinë, PTH-ja në Prizren, PTH-ja në Pejë dhe PTH-ja në Ferizaj. Mungesat e ekspertëve dhe pamundësia e angazhimit të tyre shpie deri te pamundësitë dhe vështirësitë në zbardhjen e rasteve dhe efikasitetin e prokurorive.

Vetë akterët e sistemit prokurorial theksojnë mungesën e ekspertëve të licencuar. Përveç pesë ekspertëve të përgjithshëm të angazhuar në PSRK, të cilët shërbejnë edhe për nevojat e prokurorive të tjera, i gjithë sistemi prokurorial ka në dispozicion vetëm dy ekspertë të licencuar të prokurimit publik.<sup>16</sup>

Mungesa e ekspertëve ka qenë edhe fokus i diskutimit në tryezën e organizuar me përfaqësues të sistemit prokurorial, kryeprokurorë dhe prokurorë, përfaqësues të institucioneve e agjencive të pavarura si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.<sup>17</sup>

Ndryshe nga përfaqësuesit e institucioneve të cilët në tryezë theksuan mungesën e ekspertëve dhe vështirësitë në zbardhjen e rasteve për shkak të mungesave profesionale, përfaqësues të shoqërisë civile të cilët monitorojnë prokurimin publik, theksuan se Kosova nuk vuan për shkak të mungesës së resurseve humane të cilët njohin fushën e prokurimit publik. Tutje, përfaqësues të kësaj organizate potencuan nevojën për bashkëpunim më të mirë, veçanërisht bashkëpunimin në mes të prokurorisë dhe OShP-së.<sup>18</sup>

Lidhur me bashkëpunimin, vetë drejtuesit e OShP-së gjatë tryezës përmendën mungesën e bashkëpunimit në mes të prokurorive e gjykatave në njërin anë dhe OShP-së në anën tjetër si dhe theksuan nevojën për bashkëpunim më të mirë i cili do të kontribuonte në parandalimin dhe ndëshkimin e keqpërdorimeve.<sup>19</sup>

Sidoqoftë, mungesa e ekspertëve të prokurimit është e dukshme në tërë sistemin prokurorial.

Çohu! konsideron se mungesa e ekspertëve në fushën e prokurimit publik e cila është e pranishme në sistemin prokurorial, vazhdon t'i kontribuojë vështirësisë në zbardhjen e rasteve dhe gjithashtu, mungesës së efikasitetit të prokurorive në trajtimin e rasteve të tilla.

16 Shënim: "Janë vetëm dy ekspertë të prokurimit të licencuar në krejt Kosovën. Kemi bërë kërkesë për ekspertë dhe nuk kam shans me e pas edhe 2 muaj, për shkak se janë të zënë me lëndë të tjera të prokurorit tjerë", Kujtim Munishi, shef i DKR-së dhe Njësitit për Luftimin e Korrupsionit, Krimeve Ekonomike, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme në PTH në Prishtinë, i intervistuar më 10 nëntor 2017, Prishtinë.

17 Tryeza e diskutimit me përfaqësues të institucioneve relevante dhe shoqëria civile si: Këshilli Prokurorial i Kosovës, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokuroria Speciale e Kosovës dhe prokuroritë themelore, Akademia e Drejtësisë, Agjencia Kundër Korrupsionit, Zyra Kombëtare e Auditimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Demokraci Plus (D+) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), e mbajtur më 19 dhjetor në Prishtinë.

18 Isuf Zejna – Menaxher i Programit në Demokraci Plus; Tryeza e diskutimit me përfaqësues të institucioneve relevante dhe shoqëria civile si: Këshilli Prokurorial i Kosovës, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokuroria Speciale e Kosovës dhe prokuroritë themelore, Akademia e Drejtësisë, Agjencia Kundër Korrupsionit, Zyra Kombëtare e Auditimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Demokraci Plus (D+) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), e mbajtur më 19 dhjetor në Prishtinë.

19 Blerim Dina – Drejtor në OShP, dhjetor 2017 në Prishtinë.

---

Trajtimi i rasteve të prokurimit me profesionalizëm dhe efikasitet ndihmon në zbardhjen e rasteve të shumta të cilat mbesin në fazën e dyshimeve dhe gjithashtu i ndihmon sistemit prokurorial të ketë rezultate të mira dhe ta zvogëlojë dukurinë e tillë.

Çohu! i rekomandon Këshillit Prokurorial të Kosovës të krijojë kushte për efikasitet të prokurorive. Në veçanti, KPK-ja duhet të bashkëpunojë me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) dhe të ndihmojë në le-

htësimin e punës së secilës prokurori për t'iu përgjigjur nevojave të tyre për ekspertiza në rastet e prokurimit publik.

Çohu! gjithashtu i rekomandon Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të bëjë licencimin e ekspertëve të ri të prokurimit, ekspertizat e të cilëve do të kontribuonin në zbardhjen e rasteve të shumta në prokurori dhe gjykata.

**ÇOHU!** I REKOMANDON KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS TË KRIJOJË KUSHTE PËR EFIKASITET TË PROKURORIVE. NË VEÇANTI, KPK-JA DUHËT TË BASHKËPUNOJË ME KOMISIONIN RREGULLATIV TË PROKURIMIT PUBLIK (KRPP) DHE TË NDIHMOJË NË LEHTËSIMIN E PUNËS SË SECILËS PROKURORI PËR T'IU PËRGJIGJUR NEVOJAVE TË TYRE PËR EKSPERTIZA NË RASTET E PROKURIMIT PUBLIK.

# Mungesa e evidencave të plota si dhe kategorizimi i rasteve të prokurimit publik

Mungesa e evidencave të plota për rastet e prokurimit publik si dhe mungesa e kategorizimit të këtyre rasteve është gjetje tjetër e Çohu!

Këshilli Prokurorial i Kosovës, sikurse të gjitha prokuroritë e tjera themelore dhe ajo Speciale, nuk posedojnë të dhëna të veçanta, të kategorizuara për rastet e prokurimit publik për periudhën kohore 2000-2017.

Pothuajse të gjitha të dhënat e natyrës së tillë futën në kuadër të kapitullit të veprave penale kundër korrupsionit dhe detyrës zyrtare.

Gjatë realizimit të hulumtimit, Çohu! u ka drejtuar kërkesa të gjitha prokurorive themelore dhe asaj speciale duke kërkuar rastet e prokurimit publik të proceduara ndër vite si dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Përgjithësisht asnjëra nga prokuroritë nuk ka ofruar të dhëna të plota sipas viteve.

Si përgjigje ndaj kërkesave të organizatës Çohu!, disa prokurori kanë ofruar të dhëna duke u përgjigjur pjesërisht për periudha të caktuara, derisa disa të tjera janë përgjigjur se nuk posedojnë të dhënat nëpër vite.

Bazuar në përgjigjet e dhëna, PTh-ja në Prishtinë nuk posedon fare të dhëna të kategorizuara të prokurimit publik<sup>20</sup> ndërsa PTh-ja në Gjiilan nuk posedon evidenca të sakta për rastet e proceduara të prokurimit publik ndër vite, deri në vitin 2010.<sup>21</sup>

Ndryshe nga PTh-ja në Prishtinë dhe Gjiilan, prokuroritë themelore në Pejë, Mitrovicë, Prizren, Gjakovë dhe PSRK, i janë përgjigjur pjesërisht kërkesës për të dhëna të natyrës së prokurimit publik.

Derisa PSRK-ja, PTh-ja në Prizren<sup>22</sup> dhe PTh-ja në Gjakovë<sup>23</sup> kanë ofruar të dhëna për vitin 2017, PTh-ja në Mitrovicë<sup>24</sup> ka ofruar të dhëna për vitin 2016 dhe 2017. Në anën tjetër PTh-ja në Pejë është përgjigjur

20 Shënim: "Nuk ka raste të kategorizuara të prokurimit publik dhe konsideroj se do të ishte e rëndësishme, mirëpo për momentin është e vështirë për shkak se duhet verifikuar lëndë për lëndë", Kujtim Munishi, shef i DKR-së dhe Njësitit për Luftimin e Korrupsionit, Krimeve Ekonomike, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme në PTh në Prishtinë, i intervistuar me 10 nëntor 2017, Prishtinë.

21 Shënim: "Nga viti 2010, Prokuroria në Gjiilan ka filluar trajtimin me kujdes të raporteve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm", Jetish Maloku, Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Gjiilan, tetor 2017, Gjiilan.

22 Shënim: Në PTh në Prizren, gjatë vitit 2017 gjendja me lëndët e prokurimit publik ka qenë si vijon:  
Të trashëguara: 3 kallëzime penale me 3 persona;  
Të pranuar: 5 kallëzime penale me 10 persona; Gjithsej në punë: 8 kallëzime penale me 13 persona;  
Të zgjidhura: 3 kallëzime me 5 persona (2 të pushuara, 1 bashkim në procedurë tjetër)  
Të pazgjidhura në fund: 4 kallëzime me 8 persona; Admir Shala - Kryeprokuror i PTh në Prizren, shtator 2017, Prizren.

23 Shënim: Vetëm gjatë vitit 2017, nga raporti i Auditorit janë proceduar 4 raste të kësaj natyre, Ali Selimaj - Kryeprokuror i PTh-së në Gjakovë, shtator 2017, Gjakovë.

24 Shënim: Gjatë vitit 2016 dhe 2017, PTh në Mitrovicë ka pasur në procedim 6 raste të tilla, të gjitha ende të pakryera, Shyqri Sylja - Kryeprokuror i PTh-së në Mitrovicë, shtator 2017, Mitrovicë.



## EVIDENCA E PLOTË E RASTEVE TË PROKURIMIT PUBLIK SI DHE QASJA NË TË DHËNAT E PLOTA, PËRVEÇSE DO TË DËSHMONTE TRANSPARENCËN E SISTEMIT PROKURORIAL DO TË MUNDËSONTE EDHE PASQYRIMIN E PLOTË TË GJENDJES ME RASTET E TILLA NDËR VITE.

me të dhënat nga viti 2013, duke ofruar pasqyrën e saktë edhe për mënyrën e kryerjes së tyre.<sup>25</sup>

Ndryshe nga prokuroritë e lartpërmendura, PTh-ja në Ferizaj është përgjigjur për të dhënat dhe statusin e tyre nga viti 2012, prej kur edhe është themeluar PTh-ja në Ferizaj me Departamentin e Krimeve të Rënda.<sup>26</sup>

Përfaqësues nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, mungesën e të dhënave për rastet e prokurimit dhe mungesën e kategorizimit të tyre e shohin si problem i cili vështirëson punën e vetë sistemit prokurorial dhe shoqërisë civile në anën tjetër. Sipas tyre, një databazë me rastet e prokurimit publik, do të lehtësonte punën e sistemit prokurorial si dhe punën e të gjithë të interesuarve për gjendjen me rastet e tilla dhe procedimin nga prokuroritë.<sup>27</sup>

Gjithashtu kryeprokurorë dhe prokurorë të tjerë të cilët merrnin pjesë në diskutimin për efikasitetin e prokurorive me rastet e prokurimit publik, përmendën rëndësinë dhe nevojën e kategorizimit të rasteve të prokurimit publik, disa prej të cilëve edhe e arsyetuan moskategorizimin me kategorizimin e këtyre të dhënave në rastet e korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare.<sup>28</sup>

Mosefikasiteti i prokurorive në trajtimin e rasteve të natyrës së prokurimit publik si dhe mungesa e të

dhënave pikërisht për mënyrën e zgjidhjes së rasteve nëpër vite në shumicën e prokurorive vazhdon të jetë e metë tjetër e sistemit prokurorial.

Fillimisht Çohu! konsideron se mungesa e evidencave të prokurorive lidhur me numrin e rasteve të natyrës së prokurimit publik nëpër vite dëshmon edhe njëherë mënyrën joprofesionale të punës së prokurorive dhe gjithashtu, pamundëson qasjen në pasqyrën e plotë të gjendjes me lëndët e tilla. E gjithë kjo pamundëson analizën për efikasitetin ose mungesën e efikasitetit të prokurorive lidhur me rastet e natyrës së tillë.

Në anën tjetër, përgjigjet e pjesërishme dhe të paplota të prokurorive edhe njëherë tregojnë për jotransparencën e prokurorive lidhur me punën dhe efikasitetin e tyre.

Evidenca e plotë e rasteve të prokurimit publik si dhe qasja në të dhënat e plota, përveçse do të dëshmonte transparencën e sistemit prokurorial do të mundësonte edhe pasqyrimin e plotë të gjendjes me rastet e tilla ndër vite.

Çohu! rekomandon krijimin e mekanizmave në kuadër të KPK-së të cilat do të mundësonin evidentimin e të gjitha rasteve të natyrës së prokurimit publik ndër vite, dhe gjithashtu do të mundësonin qasjen dhe analizimin e mënyrës së zgjidhjes së rasteve të tilla.

25 Shënim: Nga të dhënat e mbledhura për periudhën 2013 - 2017 ne PTh në Pejë, rezultojnë të jenë gjithsej 10 raste nga të cilat:

- 8 raste PPN, hetime të mbyllur;

- 1 hedhje posthë, si dhe

- 1 aktakuzë, e përfunduar me aktgjykim; Agim Kurmehaj - Kryeprokurori i PTh-së në Pejë, shtator 2017, Pejë.

26 Shënim: Për periudhën 1 janar 2012 - 31 gusht 2017, PTh-ja në Ferizaj kishte në punë gjithsej 3 raste me 22 persona, me ç'rast të gjitha kishte zgjidhur (të hedhura posthë: 5 persona, të pushuara 7 persona dhe aktakuzë për 10 persona); Shukri Jashari - Kryeprokuror në PTh në Ferizaj, shtator 2017, Ferizaj.

27 Besim Kelmendi - Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit; Tryeza e diskutimit me përfaqësues të institucioneve relevante dhe shoqëria civile si: Këshilli Prokurorial i Kosovës, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokuroria Speciale e Kosovës dhe prokuroritë themelore, Akademia e Drejtësisë, Agjencia Kundër Korrupsionit, Zyra Kombëtare e Auditimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Demokraci Plus (D+) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), e mbajtur me 19 dhjetor në Prishtinë.

28 Tryeza e diskutimit me përfaqësues të institucioneve relevante dhe shoqëria civile si: Këshilli Prokurorial i Kosovës, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokuroria Speciale e Kosovës dhe prokuroritë themelore, Akademia e Drejtësisë, Agjencia Kundër Korrupsionit, Zyra Kombëtare e Auditimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Demokraci Plus (D+) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), e mbajtur me 19 dhjetor në Prishtinë.



# Kushtet e rënda të punës dhe mungesa e hapësirës – Prokuroria Themelore në Mitrovicë

Për 17 vjet nga përfundimi i luftës dhe 9 vjet nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, komunat në veriun e Kosovës nuk kanë qenë të integruara në sistemin e drejtësisë së Kosovës duke e pamundësuar kështu shtrirjen e prokurorisë dhe gjykatave në gjithë territorin e komuneve në regjionin e Mitrovicës.<sup>29</sup>

Si pasojë e kësaj, përveç mungesës së shtrirjes së prokurorisë, pengesave në punë dhe mungesës së efikasitetit, qytetarëve të regjionit të Mitrovicës u ishin mohuar të drejtat themelore për qasje në drejtësi, gjykim të drejtë dhe brenda kohës së arsyeshme, që parashihet edhe me dispozitat ndërkombëtare, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe dispozitat e tjera ligjore përkatëse të Republikës së Kosovës.

Përveç pamundësisë së trajtimit të rasteve për pjesën veriore të Kosovës (në Mitrovicën Veroire, Leposaviq, Zvečan, Zubin Potok), PTh-ja e Mitrovicës në vazhdimësi është përballur me sfida të ndryshme të cilat kanë pamundësuar funksionimin normal të prokurorisë edhe pas riorganizimit të sistemit prokurorial në vitin 2013.

Bazuar në gjetjet e organizatës Çohu!, mungesa e kushteve normale dhe mungesa e hapësirave të

mjaftueshme për punë kanë ndikuar në punën e PTh-së në Mitrovicë. E gjithë kjo kishte rezultuar me vështirësi dhe mungesë të rezultateve në trajtimin e rasteve në PTh në Mitrovicë, rrjedhimisht edhe të rasteve të prokurimit publik.

Bazuar në të dhënat e siguruar nga PTh-ja në Mitrovicë për vitin 2016 dhe 2017, kjo prokurori kishte në punë gjithsej 6 raste, që të gjitha ende të pakryera, derisa për rastet e natyrës së njëjtë sipas viteve nuk ka ndonjë pasqyrë për numrin e saktë dhe mënyrën e zgjidhjes së rasteve të tilla, përkundër kërkesës që Çohu! i kishte drejtuar PTh-së në Mitrovicë.<sup>30</sup>

Shkaqet e njëjta dhe mungesa e trajtimit të lëndëve për më shumë se pesë vjet (2008-2013), kishte bërë që një numër i konsiderueshëm i rasteve në PTh në Mitrovicë të arrijë edhe afatin e parashkrimit.

Marrëveshja për Drejtësinë e arritur ndërmjet palës kosovare dhe asaj serbe në Bruksel, kishte për qëllim integrimin e veriut të Kosovës brenda sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor të Kosovës.<sup>31</sup> Në marrëveshjen e tillë, ndër të tjera ishte paraparë edhe organizimi i prokurorisë dhe i gjykatave për regjionin e Mitrovicës, rekrutimi

29 Shënim: Më 1 shtator 1999 kishte filluar punën gjyqësori në Mitrovicë. Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008, në regjionin e Mitrovicës, përkatësisht në veriun e Mitrovicës dhe komunat e tjera si Zubin Potok, Leposaviq dhe Zvečan, regjion ky i banuar me shumicë serbe, kishin plasur tensionet me ç'rast, ndër të tjera, më 20 shkurt të po atij viti ishin mbyllur gjykatat në komunat veriore të Republikës së Kosovës (Gjykatat në veriun e Mitrovicës, Zvečan dhe Zubin Potok).

30 Shënim: Kryeprokurori i PTh-së në Mitrovicë, z. Shyqri Sylja në përgjigjen e tij ndaj kërkesës së organizatës Çohu! më 11 tetor ka përmendur vetëm rastet për vitin 2016 dhe 2017, duke mos përfshirë rastet e prokurimit publik ndër vite.

31 Marrëveshja për Drejtësië e arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, 9 shkurt 2015, Bruksel.

## PËR VITE TË TËRA, QYTETARË TË SHUMTË KISHIN QENË TË PËRFSHIRË NË PROCESAT HETIMORE DHE GJYQËSORE, MIRËPO PA PASUR MUNDËSI T'Ë GËZOJNË TË DREJTAT PËR NJË PROCES TË RREGULLT, TË PAANSHËM DHE BRENDA AFATEVE TË ARSYESHME KOHORE.

i prokurorëve dhe gjykatësve të nevojshëm shqiptarë dhe serbë.

Gjatë muajit nëntor 2017, Presidenti i Republikës së Kosovës ka dekretuar prokurorë dhe gjykatës, të paraparë me Marrëveshjen për Drejtësinë. Pas dekretimit të gjykatësve, ka filluar edhe shtrirja e juridiksionit dhe bartja e Prokurorisë dhe Gjykatës Themelore të Mitrovicës edhe në komunat veriore të Kosovës.

Edhe pse në aspektin politik marrëveshja në fillim vlerësohej si një sukses sa i përket mundësisë së shtrirjes së drejtësisë edhe në veriun e Kosovës dhe integrimin e veriut brenda sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial, në aspektin praktik një gjë e tillë vazhdon të hasë në vështirësi në kuptimin e zbatimit të saj.

Për vite të tëra, qytetarë të shumtë kishin qenë të përfshirë në proceset hetimore dhe gjyqësore, mirëpo pa pasur mundësi t'ë gëzojnë të drejtat për një proces të rregullt, të paanshëm dhe brenda afateve të arsyeshme kohore.

Organizata Çohu! konstaton se pamundësia e zhvillimit të procesit të rregullt hetimor e gjyqësor dhe brenda afateve të arsyeshme, shkelja e afateve hetimore dhe ato procedurale, është shkelje e të drejtave të njeriut, sipas Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, dispozitave kushtetuese për gjykimin e drejtë dhe të arsyeshëm, Ligjit për Gjykatat si dhe sipas dispozitave procedurale penale.

Çohu! konsideron se përkundër lëvizjes në drejtim të funksionimit dhe trajtimit të rasteve të tilla në regjionin e Mitrovicës (veriu i Mitrovicës, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan), komunat veriore vazhdojnë të kenë probleme serioze në aspektin e funksionimit. Edhe pse në fillim ishte paraparë si hap drejt normalizimit dhe funksionimit të prokurorisë dhe gjykatave për krejt regjionin e Mitrovicës (duke përfshirë regjionin verior), Marrëveshja e Brukselit për Drejtësinë vazhdon të hasë në vështirësi praktike në zbatimin e saj.



# Përfundime dhe rekomandime

Bazuar në të dhënat e KPK-së, prokuroritë themelore dhe PSRK-ja viteve të fundit kanë shënuar trend pozitiv sa i përket numrin e rasteve të zgjidhura të natyrës së korrupsionit në të cilat futen edhe rastet e prokurimit publik, edhe pse numri i rasteve të hudhura poshtë dhe të pushuara, mbetet i lartë gjithashtu. Çohu! në vazhdimësi ka rekomanduar KPK-në për krijimin e mekanizmave të cilët do të analizonin arsyet dhe shkaqet e numrit të lartë të rasteve të hudhura dhe të pushuara.

Sidoqoftë sistemi prokurorial në Kosovë vazhdon të ketë probleme të shumta, të cilat vështirësojnë dhe pamundësojnë efikasitetin e prokurorive në trajtimin e rasteve të natyrave të ndryshme, rrjedhimisht rasteve të prokurimit publik.

Mungesa e numrit të mjaftueshëm të prokurorëve dhe mungesa e profilizimit të prokurorëve sipas natyrës së veprave penale, vazhdojnë të mbeten ndër defektet e mëdha të sistemit prokurorial, që rezultojnë me mungesë profesionalizmi, zvarritje të rasteve dhe mungesë efikasiteti në këtë sistem.

Edhe pse në vazhdimësi është kritikuar mungesa e transparencës për çka edhe janë ofruar rekomandimet konkrete, disa prokurori vazhdojnë të mos ofrojnë të dhënat e plota sipas viteve për lëndët e prokurimit publik. Përveç mungesës së transparencës, Çohu! ka identifikuar edhe mungesën e evidencave të plota për lëndët e prokurimit publik në disa prokurori me ç'rast ende nuk kemi pasqyrë të qartë për numrin e lëndëve të natyrës së tillë si dhe pasqyrë për mënyrën e zgjidhjes së këtyre lëndëve.

Mungesa e transparencës dhe mungesa e evidencave të plota për lëndët e prokurimit publik, përveçse dëshmon defektet e sistemit prokurorial, vazhdon t'i kushtojë këtij sistemi duke pamundësuar ofrimin e një

pasqyre të plotë për të dhënat dhe gjithashtu, analizën për mënyrën e kryerjes së rasteve të tilla.

Mungesa e ekspertëve të prokurimit publik dhe mungesa e gatishmërisë së dëshmitarëve për të dëshmuar tregojnë për vështirësitë në zbardhjen e rasteve të shumta të prokurimit publik. E gjithë kjo vazhdon ta rëndojë tutje sistemin prokurorial me efikasitetin e dobët dhe rezultatet jo të mira për natyrën e zgjidhjes së këtyre rasteve. Për të gjitha gjetjet e tilla, Çohu! ka ofruar rekomandimet konkrete.

Ashtu siç është potencuar edhe për trajtimin e çështjes së efikasitetit të prokurorive në rastet e natyrës së prokurimit publik, në prokuroritë themelore dhe PSRK janë identifikuar probleme të veçanta.

Derisa në PSRK është identifikuar mungesa e gatishmërisë së dëshmitarëve për të dëshmuar për proceset e tilla, në PTh në Mitrovicë janë identifikuar edhe problemet objektive siç është mungesa e kushteve për punë, mungesa e hapësirave, të cilat vazhdojnë t'i shkaktojnë sistemit prokurorial mungesë efikasiteti si dhe mungesë rezultatesh pozitive në zbardhjen e rasteve të tilla.

# Rekomandimet

- 1 Këshilli Prokurorial i Kosovës, duhet të krijojë kushte për trajtim efikas të rasteve të prokurimit publik;
- 2 KPK duhet të rrisë numrin e prokurorëve në proporcion me pozitat e lejuara;
- 3 Prokuroritë Themelore dhe PSRK duhet të profilizojnë dhe caktojnë prokurorë për rastet e prokurimit publik;
- 4 KPK duhet të sigurojë ekspertë të jashtëm për rastet e prokurimit publik, të domosdoshëm për zbardhjen e rasteve të prokurimit publik;
- 5 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik duhet të bëjë licencimin e ekspertëve të rinj të prokurimit;
- 6 KPK duhet të kërkojë nga secila prokurori evidencë të plotë për rastet e prokurimit publik;
- 7 Prokuroritë themelore duhet të posedojnë të dhëna të kategorizuara për rastet e prokurimit publik;
- 8 KPK duhet të rrisë kapacitetet profesionale për zbardhjen e rasteve të prokurimit publik;
- 9 Trajnimet e organizuara nga Akademia e Drejtësisë, duhet të jenë të obligueshme për prokurorët të cilët në fushëveprim kanë rastet e prokurimit publik. Këshilli Prokurorial i Kosovës në bashkëpunim me prokuroritë relevante, duhet të krijojë kushte për prokurorët, të profilizojë ata dhe të obligojë pjesëmarrjen e tyre në trajnimet e organizuara të Akademisë së Drejtësisë për fushën e prokurimit publik.
- 10 Duhet të ketë bashkëpunim të mirë në mes institucioneve që zbatojnë ligjin në fushën e prokurimit publik (Prokuroria, Policia, gjykatat, Zyra e Auditorit Gjeneral, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, komunat etj.);
- 11 Këshilli Prokurorial duhet të ofrojë kushte për dëshmitarët për rastet e prokurimit publik;
- 12 Këshilli Prokurorial duhet të krijojë kushte për shtrirje të PTh në Mitrovicë në të gjitha komunat e veriut si dhe të ofrojë kushte të mira të punës dhe hapësirë të mjaftueshme.





